| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti Filozofik-Departamenti i Historisë |
| Titulli i lëndës: | Histori e Evropës Juglindore II |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti i dytë (II), semestri III |
| Numri i orëve në javë: | 3+2 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 |
| Koha / lokacioni: | |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.Asoc.Dr. Selim Bezeraj |
| | |
| | |
| Përshkrimi i lëndës | Kjo lëndë ofron njohuri themelore mbi ngjarjet, fenomenet dhe proceset historike që shënuan popujt e Evropës Juglindore gjatë shek. XVI-XVIII<br>Vëmendja themelore do të përqendrohet në fenomenet nga fusha e zhvillimit të mendimit politik, shoqëror, kulturo-arsimor, religjionit, rregullimi politik, diplomacisë, ekonomisë etj.<br>Shek. XVI-XVIII shënoi për popullin shqiptar, ashtu si edhe për popujt tjerë të Ballkanit, një epokë të re, atë të luftës për pavarësi nga P. Osmane.<br>Kjo periudhe ka hyrë në historinë moderne të vendeve të Ballkanit si periudha e pushtimeve por edhe e lëvizjeve revolucioneve kombëtare, që ndoqën njëri-tjetrin dhe që çuan në formimin e kombëve.<br>Këto lëvizje u zhvilluan në kushtet e kulminacionit të Perandorisë Osmane por edhe të dekadencës së Perandorisë, të shthurjes së marrëdhënieve të vjetra feudale dhe të lindjes së ekonomisë së tregut, të zgjimit të mëtejshëm të ndërgjegjes kombëtare të popujve të këtij gadishulli dhe të zgjerimit të ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha në këtë Perandori por edhe tek disa vende të Ballkanit. |
| Qëllimet e lëndës: | Nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve, do të synohet që studentët jo vetëm të marrin informacionin e duhur, por edhe të nxiten për diskutime dhe analiza të pavarura rreth tematikës që do të shtjellohet gjatë procesit mësimore.<br>Përmes kësaj metodologjie studentët do arrijnë t'i kuptojnë zhvillimet politike dhe kulturore në |

| | |
|---|---|
| | kohën e konsolidimit të shteteve në Ballkan. Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të njohin më mirë Historinë e Evropës Juglindore në shek. XVI-XVIII, do jenë në gjendje t'i analizojnë dhe diskutojnë për raportet e Perandorisë Osmane dhe popujve ballkanik si dhe ndikimi në këto vende të aspektit fetar, etnik, kulturor etj; do të aftësohen për të bërë analiza dhe kritika me qellim të vlerësimeve sa më të drejta historike për këtë periudhë. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | *Nga kjo lëndë studentët:*<br>• Do ta kuptojnë dhe do të mësojnë ta interpretojnë drejtë fenomenin e krijimit të shteteve dhe përhapjen e islamizimit të popujt e Evropës Juglindore.<br>• Do ta kuptojnë ndërlidhëshmerinë dhe komperacionin e fenomeneve ekonomike, sociale, kulturore, politike dhe religjioze në Evropën Juglindore gjatë shek. XVI-XVIII.<br>• Do të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe diskutojnë fenomenet e ndryshme shoqërore të asaj kohe, veçanërisht krijimin e kombeve të para ballkanike.<br>• Studentët do jenë në gjendje t'i analizojnë dhe diskutojnë raportet e Perandorisë Osmane me popujt e Evropës Juglindore gjatë shek. XVI-XVIII. |

| Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
|---|---|---|---|
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 3 | 15 javë | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 javë | 30 |
| Punë praktike | - | - | - |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 0.30 | 10 javë | 3 |
| Ushtrime në teren | - | - | - |
| Kollokfiume,seminare | 2 | 4 javë | 8 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 1 javë | 1 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 ditë | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 15 ditë | 30 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | 1 javë | 2 |
| Projektet,prezantimet ,etj | 1 | 1 ditë | 1 |
| Totali | | | 150:25= 6 ECTS |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Punë teorike e kombinuar me ligjërata dhe prezantime të studentëve në trajtimin e historisë së mesjetës së Evropës Juglindore gjatë shek. XVI-XVIII me të gjitha specifikat që ngërthen në vete.<br>-Ligjërata *(të formës së kombinuara – interaktive)*, Metoda e Kornizës Logjike dhe metoda Brainstorming (stuhi mendimesh).<br>-Ushtrimet *(Hartimi i punimeve seminarike, diskutimi i tyre në grupe dhe komunikimi interaktiv lidhur me punimet e studentëve)*, këtu aplikohet metoda Mësimi i bazuar në projekte. | | |
| | | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi messemestral: 20%<br>Seminari dhe prezantimi 30%<br>Vijimi i rregullt obligativ 10%<br>Vlerësimi përfundimtar: 40%<br>Totali 100% | | |
| **Literatura** | | | |
| Literatura bazë: | 1. Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Prishtinë: Gutenberg, 1996.<br>2. Mehmet Maksudoglu, Historia osmane dhe institucionet, Tiranë, 2017.<br>3. Andre Clot, Sulejmani i Madhërishëm, Shkodër, 2013.<br>4. Halil Inalcik, Historia e Perandorisë Osmane, Tiranë, 2012.<br>5. Thoma Murzaka, Abaz Mullai, *Historia e Ballkanit*, Tiranë: SHBLU, 2002.<br>6. Ferdinand Schevill, *Ballkani: historia dhe qytetërimi*, Tiranë: Uegen, 2002.<br>7. Peter Bartl, Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane, XVI-XVIII, Trianë: Dituria, 2008.<br>8. Petrika Thëngjilli, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë: SHBLU, 1997.<br>9. Muhamet Tërnava, *Studime për mesjetën*, Pejë: Dukagjini, 2002.<br>10. Muhamet Tërnava, *Qytetet gjatë gjysmës* | | |

| | |
|---|---|
| | *së dytë të shek. XVI*, Prishtinë, 1997; |
| Literatura shtesë: | -Noel Malkolm, *Kosova- një Histori e shkurtër*, Prishtinë: KOHA, 2001.<br>-Stanford J. Shaw, *Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne*, Tiranë: Jehona Study Center, 2006. |

**Plani i dizajnuar i mësimit:**

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|---|---|
| Java e parë: | Njohja me Lëndën, Burimet dhe Literatura,Vështrim i Përgjithshëm mbi përiudhen që e karakterizon Historinë e Evropës Juglindore në shek. XVI-XVI |
| Java e dytë: | Pushtimet Osmane në Evropën Juglindore gjatë shek. XVI |
| Java e tretë: | Organizimi shtetëror Osman në Evropën Juglindore |
| Java e katërt: | Perandoria Osmane dhe popujt e Evropës Juglindore-Sistemi i timarit dhe miletit |
| Java e pestë: | Përhapja e Islamit në Evropën Juglindore |
| Java e gjashtë: | Ndryshimet politike dhe ushtarake në Perandorinë Osmane dhe Habsburge në fund të shek. XVI dhe shek. XVII |
| Java e shtatë: | Kollokfiumi i parë |
| Java e tetë: | Lufta e Ligës së Shenjtë kundër Perandorisë Osmane (1593-1606) |
| Java e nëntë: | Kuvendet ndërballkanike dhe Lëvizja çlirimtare e popujve të Ballkanit në fund të shek.XVII |
| Java e dhjetë: | Kultura dhe arti në Evropën Juglindore gjatë shek. XVI-XVIII |
| Java e njëmbëdhjetë: | Ekonomia dhe tregtia e Evropës Juglindore gjatë shek. XVI-XVIII |
| Java e dymbëdhjetë: | Lufta austro-osmane 1683-1699 dhe popujt e Evropës Juglindore |
| Java e trembëdhjetë: | Perandoria Osmane dhe Evropa Juglindore në periudhën e revolucionit Francez dhe të Napolon Bonapartës |
| Java e katërmbëdhjetë: | Traktati i Kyçyk-Kajnarxhasë dhe pamja e Evropës Juglindore pas luftës ruso-osmane |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Kollokfiumi i dytë |

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

- Hyrja me kohë në ligjërata - e domosdoshme. Vonesa mbi 10 minuta nuk justifikohet;
- Telefonat celularë shkyçen para se të fillojë procesi mësimorë;
- Kopjimi gjatë kollokfiumeve dhe provimit final - i ndaluar dhe ndëshkohet;
- Çdo kontakt me profesorin e lëndës lidhur me çështjet që dalin nga lënda

**përkatëse - nëpërmjet e-mail adresave, ditëve të parapara për konsultime dhe ne raste urgjente edhe përmes telefonit.**

** Statuti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" përfshinë politikat e mirësjelljes akademike dhe misionin arsimor e shkencor të universitetit.*